

Thirrje për kurator për Pavijonin e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “Expo 2020 Dubai”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) shpall thirrjen për kurator për Pavijonin e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar “Expo 2020 Dubai”, që do të zhvillohet në datat 20 tetor 2020 – 10 mars 2021, në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe. Aplikantët e interesuar duhet të paraqesin një projekt-propozim nën tematikën “Albania, a timeless journey”.

Kjo thirrje do të qëndrojë e hapur deri më **24.01.2020**.

Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët:

- të jenë shtetas shqiptarë ose të huaj, me rezidencë në Shqipëri
- të kenë minimumi 10 vite eksperiencë pune, përfshirë përvoja të rëndësishme ndërkombëtare
- të kenë qenë kurator ose pjesë e një grupi kuratorial në ekspozita kombëtare dhe ndërkombëtare
- të kenë përvojë drejtuese në një institucion të rëndësishëm shqiptar për të paktën 5 vite
- të kenë fituar një profil të rëndësishëm kombëtar

Kandidati fitues duhet të marrë përsipër të:

- mbajë lidhje me grupin e punës dhe stafin e organizatorëve të Expo 2020 Dubai me qëllim përmbushjen e të gjitha kërkesave;
- koordinojë të gjitha aspektet logjistike me karakter artistik të realizimit të Pavijonit të Shqipërisë në bashkëpunim me grupin e punës;
- mbajë lidhje me donatorë të mundshëm dhe të bashkëpunojë me galeri, muze apo koleksionistë për të ndihmuar mbulimin e kostove të pavijonit;
- ideojë dhe menaxhojë katalogun zyrtar të Pavijonit të Shqipërisë;

Kriteret e Projektit

Projekt-propozimet e paraqitura duhet të konsistojnë në:

- shtjellimin e tematikave të ndryshme që lidhen me këtë koncept dhe rëndësinë e tyre;
- një argumentim se pse punët e zgjedhura përshtaten me konceptin qendror të Pavijonit të Shqipërisë;
- përshkrim i punës/punëve që do të ekspozohen në kuadrin e Pavijonit;
- draft-buxhet (nuk është e nevojshme që buxheti të jetë i detajuar në këtë pikë);
- CV të kuratorit;

Procedura e Përzgjedhjes

Projekt-propozimet e paraqitura do të shqyrtohen nga një komision i përbërë nga 3 (tre) anëtarë.

Fituesi do të shpallet më datë 30.01.2020.

Gjatë përzgjedhjes do të merren parasysh:

- karriera e kuratorit
- aftësia e tij për të ndërmarrë një ekspozitë ndërkombëtare;
- vlerat artistike të propozimit, ku një theks i veçantë do t'i vihet forcës konceptuale dhe evokative të propozimit;
- realizueshmëria financiare në kontekstin e burimeve në dispozicion.

Projekt-propozimet duhet të dorëzohen dorazi në adresën e mëposhtme:

***Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
Blv “Dëshmorët e Kombit”, Kryeministria, Kati III, Tiranë***